



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI FILOZOFIK

"Eqrem Çabej" Nr. 21, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 381-38-224783, Fax: + 381-38-244035,

E-Mail: filozofiku@uni-pr.edu, www.uni-pr.edu

Dekani:

Bujar Dugolli

Nr. ref. 1348/02
Prishtinë, 22.06.2020

Në përputhje me Statutin e Universitetit të Prishtinës, Rregulloren për punën e Këshillit të Fakultetit nr. 772 e datës: **06/03/2020** e miratuar nga Këshilli Drejtues i UP-së, Këshilli i Fakultetit Filozofik në mbledhjen e mbajtur me datën: 01/05/2020, aprovoi këtë:

RREGULLORE MBI ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FAKULTETIT FILOZOFIK

Neni 1 Qëllimet

- 1.1 Sigurimi i një mjedisi cilësor, miqësor dhe bashkëpunues brenda institucionit, të bazuar në rregulla dhe procedura të avancuara dhe funksionale.
- 1.2 Rregullimi i strukturës së brendshme organizative dhe funksionimit të saj brenda Fakultetit Filozofik.

Neni 2 Fushëveprimi

2.1 Fakulteti Filozofik vepron në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit të Prishtinës, duke ofruar programe të arsimit të lartë, kërkime shkencore dhe krijimtari artistike të bazuara në Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe Ligjin e arsimit të lartë në Kosovë.

Neni 3

Fakulteti Filozofik ofron këto nivele të studimeve:

- 3.1. Studimet themelore – BA (Bachelor);
- 3.2. Studimet master: MA (Master shkencor dhe Master profesional);
- 3.3. Studimet e doktoratës (PhD).

Neni 4

Në Fakultetin Filozofik veprojnë këto nivele të nënndarjes hierarkike:

- 4.1. Këshilli i Fakultetit Filozofik;
- 4.2. Departamenti (fusha të përgjithshme të shkencës apo arteve);
- 4.3. Instituti (fusha speciale të shkencës apo arteve);
- 4.4. Administrata e Fakultetit;
- 4.5. Këshilli i Studentëve.

Neni 5

Fakulteti Filozofik në bazë të statutit të UP-së është përgjegjës për sa vijon:

- 5.1. T'ia propozojë Senatit programet e studimeve;
- 5.2. Të organizojë mësimdhënien, provimet dhe vlerësimet e studentëve;
- 5.3. Të mbikëqyr progresin akademik të studentëve, duke përfshirë shërbimet akademike dhe administrative të studentëve;
- 5.4. Të zhvillojë kërkime shkencore apo krijimtari artistike sipas standardeve të avancuara ndërkombëtare;
- 5.5. Të sigurojë cilësinë, vlerësimin dhe çështjet e raportimit, siç është paraparë me këtë rregullore dhe Statutin e UP-së;
- 5.6. Të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet financiare dhe infrastrukturore, siç është paraparë me rregulloret përkatëse dhe Statutin e UP-së;
- 5.7. Të merret me çështjet e personelit akademik dhe administrativ, sipas dispozitave të Statutit të UP-së dhe rregullativës tjetër;
- 5.8. Të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet e planifikuara dhe të alokuara nga Këshilli Drejtues i UP-së.

Neni 6

Fakulteti Filozofik udhëhiqet nga Dekani, të cilin mund ta ndihmojnë një, dy ose tre prodekanë.

Neni 7

7. 1. Dekani dhe prodekanët zgjidhen nga Këshilli i Fakultetit Filozofik nga radhët e anëtarëve të zgjedhur të këshillit, me shumicën absolute të votave dhe i propozohen Senatit për miratim për një periudhë katërvjeçare, nga radha e profesorëve të fakultetit me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.

7. 2. Kandidatët për postin e Dekanit dhe të prodekanëve duhet të jenë individë me kualifikime relevante akademike dhe të kenë aftësi dhe përvojë në udhëheqje, si dhe të kenë së paku thirrjen e profesorit asistent.

7. 3. Dekani i zgjedhur ia propozon Këshillit të Fakultetit Filozofik prodekanët e mundshëm për mandatin e përbashkët, të cilët zgjidhen në këshill dhe i përcillen Senatit për miratim.

7. 4. Për zgjedhjen e Dekanit të ri, këshilli i njësisë akademike e zgjedh një anëtar të këshillit nga profesorët e fakultetit, i cili përkohësisht e mban mandatin e Dekanit në Senat, derisa të përfundojë procedura e zgjedhjes së Dekanit të ri. Dekani i ri e merr mandatin ashtu siç parashihet me Statut të UP-së dhe rregulloren e zgjedhjeve në UP.

7. 5. Mandati i rregullt i Dekanit, prodekanëve, shefave të departamenteve dhe sekretarëve fillon më një (1) tetor.

Neni 8

8.1. Mandati i Dekanit mund të përfundojë para kohe në rast të:

- a) Dorëheqjes;
- b) Shkarkimit;
- c) Arsyeve shëndetësore;
- d) Dënimit për vepër penale;
- e) Pensionimit;
- f) Vdekjes.

8. 2. Procedura për shkarkimin e Dekanit mund të iniciohet nga:

- a) Këshilli drejtues;
- b) Senati;
- c) Rektori;
- d) Këshilli i Fakultetit Filozofik.

8. 3. Procedura dhe arsyet për shkarkimin e Dekanit përcaktohen në rregulloren e nxjerrë nga Senati i UP-së.